



RAPORT 2023

Shërbimi Social Shtetëror

RAPORT

2023

Tiranë 2024

TABELA E PËRMBAJTJES

	HYRJE.....	4
I.	DREJTORIA E KONTROLLIT TË PAGESËS SË NE DHE PAK.....	5
II.	DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE.....	19
III.	DREJTORIA E KOMISIONIMIT TË PAK.....	26
IV.	DREJTORIA E FINANCËS DHE STATISTIKËS.....	29
V.	DREJTORIA E SHËRBIMEVE TË BRENDSHME.....	40

HYRJE

Ky raport pasqyron aktivitetin e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror duke përmbledhur edhe aktivitetin e institucioneve të varësisë gjatë vitit 2023. Raporti është i organizuar në formën e një raportimi të detajuar të aktivitetit të çdo Drejtorie në Drejtorinë e Përgjithshme të SHSSH në zbatim të objektivave të institucionit për vitin 2023.

Raportimet për çdo drejtori paraqesin në mënyrë krahasimore veprimtarinë dhe arritjet ndër vite duke evidentuar përmirësimin e dukshëm të performancës së institucionit në të gjithë komponentët e punës së tij:

- Mirëmënaxhimin e skemës së ndihmës ekonomike;
- Modernizimin e skemës së Aftësisë së kufizuar;
- Shërbimet e përkujdesit social;
- Mirëadministrimin financiar dhe të burimeve njerëzore;
- Menaxhimi i kujdesshëm i kërkesave dhe ankesave të njerëzve në të gjitha format e paraqitura, përmes platformës së bashkëqeverisjes, medias, rrjeteve sociale apo direkt pranë zyrave të këtij shërbimi.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

REME XHOLI

I. DREJTORIA E KONTROLLIT TË PAGESËS SË NE DHE PAK

Drejtoria e Kontrollit të Pagesës së NE dhe PAK, funksionon në bazë të strukturës së SHSSH me dy sektorë: Sektori i Kontrollit të NE dhe Sektori i Kontrollit PAK dhe zhvillon veprimtarinë në zbatim të Ligjit Nr.57, datë 18.07.2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, VKM-së Nr.597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, VKM-së Nr. 257, datë 05.05.2021 “ Për procedurat e kryerjes së kontrollit të zbatimit të legjislacionit të asistencës sociale”, Shtojca Nr.1 “Metodologjia e Kontrollit të ndihmës ekonomike”. VKM 722, datë 11.11.2019 “Për Përcaktimin e Masës , të Kriteve, Proçedurave dhe Dokumentave për Vlerësimin dhe Përfitimin e Aftësisë së Kufizuar të Ndihmës Personal, dhe të Strukturave Përgjegjëse e të Detyrave të Tyre ” i ndryshuar si dhe VKM Nr. 431, datë 08.06.2016 “Për Përcaktimin e Kriteve, të Dokumentacionit, të Proçedurave, dhe të Masës së Përfitimit e Pagesës së Aftësisë së Kufizuar e të Ndihmës Personal dhe të Strukturave Përgjegjëse e të Detyrave të Tyre në Zonat Pilot”, VKM 722, datë 11.11.2019 “Për Përcaktimin e Masës , të Kriteve, Proçedurave dhe Dokumentave për Vlerësimin dhe Përfitimin e Aftësisë së Kufizuar të Ndihmës Personal, dhe të Strukturave Përgjegjëse e të Detyrave të Tyre ”, të ndryshuar, Metodologjinë e Kontrollit të Vlerësimit Bio-Psiko-Social të Aftësisë së Kufizuar ” si dhe Urdhërit Nr.462 datë 29.10.2021 “ Për Shtrirjen e Sistemit të Vlerësimit Bio-Psiko-Social të Aftësisë së Kufizuar dhe Mekanizmin e Kontrollit dhe Monitorimit ”.

1.1 Dinamika e skemës së NE-së për periudhën Janar – Dhjetor 2023

1.1.1 Ecuria e skemës së ndihmës ekonomike për periudhën Janar - Dhjetor 2023

Dinamika e skemës së NE-së për periudhën janar –dhjetor 2023 përfshin përfituesit në total të sistemit të pikëzimit dhe familjet e trajtuara me fondin deri në 6%. Sipas raportit aplikues / përfituese nga sistemi, shikohet se mesatarisht 95% e familjeve/individëve janë përfitues.

Muaji	Aplikues	Perfitues Sistem NE+Kategori	% aplikues perfitues
Janar	62251	58237	94%
Shkurt	62343	59303	95%
Mars	62903	59552	95%
Prill	62678	60117	96%
Maj	63195	60621	96%
Qershor	63088	59579	94%
Korrik	61517	58473	95%
Gusht	60602	58222	96%
Shtator	60156	56671	94%
Tetor	59297	55276	93%
Nentor	57660	54646	95%
Dhjetor	54181	53266	98%

Raporti hyrje të reja, përfitues sistemi, përfitues 6%, përfitues total dhe refuzime për vitin 2023


Muaji	Nr.Familjeve Sistem	Nr.familje 6%	Nr familje ne nevoje Sistem + 6%	Kategorite	Total Perfitues	Hyrje te reja	Refuzuar
Janar	55942	4429	60371	2295	62666	1731	4014
Shkurt	57019	4637	61656	2284	63940	1610	3040
Mars	57284	4944	62228	2268	64496	1522	3351
Prill	57843	4871	62714	2274	64988	1408	2561
Maj	58319	4732	63051	2302	65353	1126	2574
Qershor	57328	4669	61997	2251	64248	858	3509
Korrik	56246	4511	60757	2227	62984	959	3044
Gusht	55994	4538	60532	2228	62760	723	2380
Shtator	54512	4386	58898	2159	61057	860	3485
Tetor	53201	4410	57611	2174	59785	828	4021
Nentor	52424	4428	56852	2222	59074	745	3014
Dhjetor	51044	4045	55089	2222	57311	706	3281

**Dinamika e refuzimeve me arsye të ndryshme për çdo muaj e shprehur në %
Refuzime të klasifikuara sipas muajve**

Muaji	Mosparaqitje deklarim 3 mujor	% mosparaqitje/refuzim total	Mospërputhje	% mospërputhje/refuzime total
Janar 2023	398	10%	1607	40%
Shkurt 2023	71	2%	1044	34%
Mars 2023	225	7%	1486	44%
Prill 2023	333	13%	918	36%
Maj 2023	101	4%	1072	42%
Qershor 2023	557	16%	1654	47%
Korrik 2023	871	29%	1125	37%
Gusht 2023	238	10%	1085	46%
Shtator 2023	500	14%	1999	57%
Tetor 2023	920	23%	1814	45%
Nëntor 2023	423	14%	1323	44%
Dhjetor 2023	699	22%	1436	46%

Dinamika e refuzimeve si pasojë e deklarimeve jo të sakta gjatë aplikimeve, vihet re që është më e lartë në muajin janar që përkon me fillim viti dhe ka deklarime të reja dhe për pasojë trajtohen mospërputhjet gjatë procesit të verifikimit me Institucionet e tjera. Referuar muajve Korrik dhe tetor numri i refuzimeve për mosparaqitje të anëtarëve madhore gjatë deklarimit 3-

mujor është më i lartë se muajt e mëparshëm pasi përkon me periudhën kur përfituesit ekzistues duhet të paraqiten për të kryer deklarinimin 3-mujor. Gjithashtu si pasojë e kontrolleve tematike të ushtruara për vizitat në banesë nga 12 Drejtoritë Rajonale janë larguar familje nga skema endihmës ekonomike gjatë procesit të vendimmarrjes.



Dinamika e refuzimeve sipas Qarqeve

Qarqet që kanë refuzimet më të larta janë Elbasan, Dibër, Korçë dhe Kukës pasi janë Qarqe me numrin më të lartë të familjeve përfituese nga skema e ndihmës ekonomike.

Një indikator tjetër i rëndësishëm në numrin e të refuzuarve nga skema lidhet me integrimin dhe orientimin drejt tregut të punës të anëtarëve madhorë në moshë aktive pune. **Sipas analizës së 12 DR SHSSH, në gjashtë mujorin e parë të vitit 2023 janë larguar 46% e familjeve që kanë qenë familje përfituese pasi janë punësuar në gjashtë mujorin e dytë të vitit 2022.** Sipas Qarqeve numri i të larguarve nga skema si pasojë e punësimit është:

Fieri 78%, Durrës 69 %, Vlorë 58%, Shkodër 58 %, Lezhë 56%, Elbasan 53 %, Korçë 53 %, Dibër 49 %, Tiranë 40 %, Berat 37%, Kukës 37 % dhe Gjirokastrë 8 %.

1.2 Zbatimi i legjislacionit për ndihmën ekonomike nëpërmjet kontrolleve të ushtruara pranë njësive vendore

Tabela e kontrolleve

Qarku	Njësia Administrative	Numri i familjeve në NE	Numri i dosjeve të kontrolluara	Numri i verifikimeve sociale ekonomike	Numri i familjeve të larguara	Raste Mashtrimi		Raste Gabimi		DËMI		Numri i Personave me PAK	Nr dosjeve me probleme me PAK	Dëmi Ekonomik	Numri i Invalideve të Punës	Nr i dosjeve me probleme	Dëmi Ekonomik	DËMI EKONOMIK		MASA ADMINISTRATIVE
						Nr. Familjeve	Fondi	Nr. Familjeve	Fondi	Nr. Familjeve	Fondi							Nr. Dosje total me probleme	Fondi	
Tiranë	19 kontrolle	1831	701	93	30	0	0	0	0	0	0	8170	6	122753	7199	2	40500	8	163253	3 Masa Disiplinore + 2 Masë Shpërblim dëmi
Durrës	10 kontrolle	672	448	312	27	0	0	50	388899	50	388899	3133	56	1199926	2616	20	155100	76	1355026	8 Masa Shpërblim Dëmi + 2 Masë Disiplinore
Elbasan	26 kontrolle	7365	1774	405	25	40	1793977	6	96674	46	1890651	3935	25	600062	2708	10	36300	35	636362	22 Masa Shpërblim Dëmi + 3 Masa Disiplinore
Korçë	13 kontrolle	2532	1140	237	41	0	0	4	53762	4	53762	492	6	115295	438	0	0	6	115295	3 Masa Shpërblim Dëmi
Vlorë	23 kontrolle	1352	1227	303	7	0	0	4	37462	4	37462	2739	2	35631	4982	0	0	2	35631	2 Masë Disiplinore + 3 Shpërblim dëmi
Lezhë	21 kontrolle	2656	829	256	40	0	0	12	365785	12	365785	1573	9	500574	1620	1	3300	10	503874	7 Masa Shpërblim Dëmi
Gjirokastër	16 kontrolle	577	690	178	14	3	21167	0	0	3	21167	1279	6	245761	888	9	57030	15	302791	7 Masa Shpërblim Dëmi
Shkodër	26 kontrolle	2291	1206	144	0	0	0	183	3102093	183	3102093	2597	110	3695789	1164	18	151300	128	3847089	19 Masa Shpërblim Dëmi + 9 Masa disiplinore + 5 Gjoha
Fier	22 kontrolle	748	394	346	55	3	25028	21	240220	24	265248	3140	8	391516	2633	1	3300	9	394816	9 Masa Shpërblim Dëmi + 2 Masa Disiplinore
Kukës	21 kontrolle	6326	1252	247	41	0	0	67	2337212	67	2337212	875	51	1658645	900	3	28600	54	1687245	19 Masa Shpërblim Dëmi
Dibër	34 kontrolle	10,936	1,873	712	66	1	33,327	280	504,574	281	537,901	2,874	76	845,753	2,448	98	339,400	174	1185153	28 Masa Shpërblim Dëmi + 8 Masa disiplinore + 2 Gjoha
Berat	23 kontrolle	667	975	165	29	0	0	27	417468	27	417468	2202	40	1037608	1705	22	99710	62	1137318	1 Masë disiplinore, 1 Gjohë
TOTALI	266 KONTROLLE	37953	12509	3398	375	47	1873499	654	7544149	701	9417648	33009	395	10449313	29301	184	914540	579	11363853	171 MASA GJITHSEJ (130 SHD + 33 MD + 8 GJ) (DRSHSSH + NE)

1.2.1 Problematikat e konstatuara gjatë kontrolleve të kryera nga DKP NE&PAK në Drejtoritë Rajonale/Bashki/Njësi Administrative

- Plani i punës për vitin 2023 nuk është realizuar plotësisht nga të gjitha Drejtoritë Rajonale
- Procedura për kategorinë “Prindërit me më shumë se 2 fëmijë të lindur njëherësh”, dhe “Jetimët, të cilët nuk janë në Institucione të përkujdesjes shoqërore”, mospërputhjet e ardhura nga DPT, ISSH, DPSHTRR, AKPA, DPGJC dhe Vizita në shtëpi, nuk janë trajtuar nga ana e verifikuesit si dhe nuk janë bërë komentet përkatëse se përse nuk konsiderohen shkelje për **Drejtoritë Fier dhe Dibër**.
- Familje/individë përfitues në skemën e ndihmës ekonomike, me kushte shumë të mira sociale ekonomike.

- Zbatimi i detyrave të lëna nga Drejtoritë Rajonale në Njësi/Bashki, nuk janë realizuar plotësisht, nuk është ndjekur ecuria e familjeve përfituese në skemën e ndihmës ekonomike.
- Plotësimi jo i saktë i formularit të aplikimit nga administratori shoqëror si dhe rastet e përfituesve si kategori e PAK/Invaliditet, për të cilët jo gjithmonë është çekuar pyetja nëse përfiton ndonjë anëtar i familjes pension Invaliditet ose PAK, duke mos e çekuar pyetjen, familjet kanë përfituar pagesën edhe si kategori PAK dhe si anëtar i familjes së NE-së.
- Detyrat dhe përgjegjësitë e strukturës kontrolluese nga Drejtoritë Rajonale janë realizuar pjesërisht dhe jo në zbatim të VKM-së 257, datë 05.05.2021 “Për procedurat e kryerjes së kontrollit të zbatimit të legjislacionit të Asistencës Sociale ”Shtojca Nr.1” Metodologjia e Kontrollit Të Ndihmës Ekonomike ”, për kontrollet që janë realizuar, jo në të gjitha rastet pjesa e gjetjeve ka qenë e detajuar dhe specifike si dhe në disa raste nuk ka qenë i mundur identifikimi për familjet/individët të cilët janë përfitues ose kanë përfituar padrejtësisht në kundërshtim me ligjin, pasi familjet janë vendosur me iniciale në raportin e kontrollit.
- Verifikimi i situatës social-ekonomike në banesë që duhet të kryhet nga administratori shoqëror i njësisë, mungojnë ose janë kryer me vonesë dhe jo brenda muajit të parë të aplikimit për hyrjet e reja dhe dy herë në vit për ato ekzistuese ashtu si ligji e parashikon, procedurë shumë e rëndësishme për të verifikuar situatën reale të familjeve nëse ato janë realisht në kushtet e përfitimit të pagesës si familje në nevojë, por dhe shumë e rëndësishme në vendimmarrjen e Drejtorisë Rajonale bazuar në Ligjin 57/2019, “ Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, Kreu V, Neni 23, gërma c)...
- Verifikimi i situatës social-ekonomike për të parë përputhshmërinë e deklaramit të kryer pranë administratorit shoqëror dhe kushteve reale në banes, nga ana e grupit të kontrollit në Drejtoritë Rajonale **vizitat në banesë nuk janë kryer nga DR Tiranë, Gjirokastër** ndërsa në Drejtoritë e tjera vizitat janë kryer në numër shumë të vogël.
- Administratorët shoqërorë nuk kanë plotësuar saktë formularin e vizitës në familje sipas të gjitha rubrikave përkatëse dhe ka pasur probleme me hedhjen në sistem. Në rastet kur ka ndryshime duhet të çekohet pyetja “po” ka ndryshime nga deklarimi gjatë hedhjes në sistem të vizitës në familje dhe pasqyrimi i të gjitha ndryshimeve me qartësi dhe korrektësi.
- Mosorganizim të dosjeve dhe dokumentacionit si dhe shumë familje pa vizita, vizitat janë kryer me vonesë ose nuk janë kryer brenda muajit të parë të aplikimit për familjet që aplikojnë për herë të parë si dhe dy herë në vit për familjet përfituese me ndihmë ekonomike.
- Drejtoritë Rajonale, jo në të gjitha njësitë është kryer kontroll i detajuar mbi planifikimin e fondeve, procedurën e ndjekur ndërmjet Bashkisë dhe Postës/Bankës për rakordimin, përputhjen midis fondit të planifikuar, atij të shpërndarë dhe gjendjen faktike. Rezulton se nga ana e Drejtorive Rajonale nuk është zbatuar ndjekja dhe realizimi i fondeve në të gjitha Njësitë pasi nga ana e Postës/Bankës nuk janë disponuar akt rakordime dhe borderotë/lista emërore e familjeve.

- Në lidhje me zbatimin e penaliteteve 6 mujore dhe 1 vjeçare është vënë re se, nga ana e administratorit shoqëror nuk respektohet afati ligjor i penalizimit 6-mujor dhe 1-vjeçar për familjet e refuzuara nga skema e ndihmës ekonomike në kundërshtim me Ligjin 57/ date 18.07.2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”.
- Raportet e gjeneruara në sistem, jo në të gjitha rastet është respektuar afati lidhur hartimin e Projekt raportit/Raportit përfundimtar të kontrollit, gjithashtu rezultoi se, në kontrollet e kryera nga Drejtoritë Rajonale problematik të theksuar kanë moszbatimin e detyrave të lëna lidhur me shpërbimin e dëmit për familjet që e kanë përfituar ndihmën ekonomike në kundërshtim me ligjin si dhe mos mbajtja e të dhënave të sakta nga strukturat përgjegjëse lidhur me arkëtimet.
- Lidhur me shumën e përfituara padrejtësisht nga familjet, nga DR janë dërguar shkresa të përsëritura për ndalesa, por nuk janë arkëtuara pagesat sipas zërave të përcaktuar në VKM Nr.257/2021”Për procedurat e kryerjes së kontrollit të zbatimit të legjislacionit të asistencës sociale”, Shtojca Nr.1, Metodologjia e kontrollit të ndihmës ekonomike, Kreu V, 3.3.6, pika d) .. Nëse dëmi i shkaktuar i përket vitit aktual, atëherë zhdëmtimi i dëmit bëhet nëpërmjet kthimit të tij në “ Llogarinë nr.606”, në rastet kur dëmi i shkaktuar i përket viteve të mëparshme , atëherë shuma e zhdëmtimit kthehet në llogarinë “ Të ardhura nga buxheti i shtetit”.
- Një ndër problematikat e konstatuara në disa prej kontrolleve të ushtruara nga Drejtoritë Rajonale, qëndron në vendosjen e masave administrative pasi konstatohet se në disa kontrolle për shkeljet e konstatuara nuk propozohen masat përkatëse ose masat e vendosura nuk janë në përputhje me legjislacionin.

1.2.2 Problematikat e konstatuara gjatë kontrolleve të kryera nga Drejtoritë Rajonale në Bashki/Njësi Administrative

- Familje/individë përfitues në skemën e ndihmës ekonomike, me kushte shumë të mira social ekonomike.
- Zbatimi i detyrave të lëna nga Drejtoritë Rajonale në Njësi/Bashki, nuk janë realizuar plotësisht nga administratorët shoqërorë.
- Plotësimi jo i saktë i formularit të aplikimit nga administratori shoqëror si dhe rastet e përfituesve si kategori e PAK/Invaliditet, për të cilët jo gjithmonë është çekuar pyetja nëse përfiton ndonjë anëtar i familjes pension Invaliditet ose PAK, duke mos e çekuar pyetjen, familjet kanë përfituar pagesën edhe si kategori PAK dhe si anëtar i familjes së NE-së.
- Verifikimi i situatës social-ekonomike në banesë që duhet të kryhet nga administratori shoqëror i njësisë, mungojnë ose janë kryer me vonesë dhe jo brenda muajit të parë të aplikimit për hyrjet e reja dhe dy herë në vit për ato ekzistuese ashtu si ligji e parashikon, procedurë shumë e rëndësishme për të verifikuar situatën reale të familjeve nëse ato janë realisht në kushtet e përfitimit të pagesës si familje në nevojë, por dhe shumë e rëndësishme në vendimmarrjen e Drejtorisë Rajonale bazuar në Ligjin 57/2019, “ Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, Kreu V, Neni 23, gërma c)...
- Administratorët shoqërorë nuk kanë plotësuar saktë formularin e vizitës në familje sipas të gjitha rubrikave përkatëse dhe ka pasur probleme me hedhjen në sistem. Në rastet

kur ka ndryshime duhet të çekohet pyetja “po” ka ndryshime nga deklarimi gjatë hedhjes në sistem të vizitës në familje dhe pasqyrimi i të gjitha ndryshimeve me qartësi dhe korrektësi.

- Mosorganizimi i dosjeve dhe mungesa në dokumentacionin e cituar në legjislacionin e NE-së.
- Referuar verifikimeve në rubrikën e vizitës në shtëpi ka rezultuar se, procedura e ndjekur nga ana e administratorëve shoqërore për vizitat e kryera në banesë nuk ka qenë e saktë. Të gjitha ndryshimet social ekonomike që ndodhin tek familjet përfituese, të cilat sipas VKM-së Nr.597/2019, Kreu II, pika 4... duhet të deklarohen në deklaratat 3 mujore që plotësohen pranë administratorit shoqëror nga anëtarët madhor të familjes, në praktikë deklarohen tek vizitat në banesë, duke ndryshuar në këtë mënyrë edhe qëllimin e vizitave në familje të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi.
- Në njësitë administrative nuk disponohen kopje të borderosë/lista emërore e familjeve e cila pengon punën e grupit të kontrollit për kontrollin e familjeve lidhur me tërheqjen e pagesave çdo muaj.
- Nuk respektohet afati ligjor i penalizimit 6-mujor dhe 1- vjeçar nga ana e administratorit shoqëror për familjet e refuzuara nga skema e ndihmës ekonomike, në kundërshtim me Ligjin 57/ date 18.07.2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”.
- Lidhur me arkëtimin e shumave, është evidentuar nga Drejtoritë Rajonale problematik e theksuar mbi shpërbimin e dëmit për familjet që e kanë përfituar ndihmën ekonomike në kundërshtim me legjislacionin si dhe mos mbajtja e të dhënave të sakta nga strukturat përgjegjëse lidhur me arkëtimet.
- Familje që trajtohen me fondin deri në 6% pa përmbushur kriteret.
- Mosfirmosje të deklaratave 3-mujore nga të gjithë anëtarët madhorë të familjes

1.3 Risitë në programin e NE-së

- Shërbime online në e-albania, Vërtetim negativ për Familje/Individë që nuk janë përfitues nga skema e ndihmës ekonomike
- Shërbime online në e-albania, Vërtetim negativ për Familje/Individë që nuk janë përfitues nga fondi 6%
- Shërbime online në e-albania, Vërtetim negativ për Individë që nuk janë përfitues të pagesës së PAK.

1.4 Konsolidimi i skemës së ndihmës ekonomike me anë të mirëadministrimit të regjistrimit Elektronik Kombëtar dhe sistemit të pikëzimit

- Monitorimi i sistemit të Ndihmës Ekonomike. Analizimi dhe ndjekja e problematikave të raportuara nga përdoruesit tek kompania e mirëmbajtjes në platformën e suportit.
- Përpunim raportesh statistikore, të nxjerra nga sistemi i Ndihmës Ekonomike, në lidhje me familjet aplikuese, përfituese refuzuara etj.
- Ndjekja e ecurisë së verifikimeve si dhe udhëzime të vazhdueshme drejtorive rajonale lidhur me trajtimin e mospërputhjeve për përfituesit ekzistues dhe aplikuesit e rinj.

- Ndjekja e procesit të vendimmarrjes së Drejtorive Rajonale. Përgatitur tabelat statistikore progresive për muajt Janar-Dhjetor 2023, përfitues, refuzuar, refuzuar për mospërputhje, refuzuar për pike, hyrje të reja, kategori të veçanta etj.
- Monitoruar raporti i fondit 6%, në sistem dhe komunikuar me Drejtorinë Rajonale për mbylljen e procesit të rekomandimeve në afatin e sistemit. Komunikuar me Drejtorinë Rajonale në lidhje me problematikat e rekomandimeve në fondin 6%
- Realizuar ndërveprimi i sistemeve me AKPA për zbatimin e urdhërit të përbashkët për referimin, punësimin dhe integrimin social të anëtarëve në moshë aktive pune të skemës së NE.
- Takim me IKUB dhe AKPA lidhur me krijimin e një data base mbi rastet e shqyrtuara dhe të riintegruara si dhe krijimi i modulit për aksesimin e ruajtjes së rekordeve në sistem për anëtarët në moshë aktive pune, që rezultojnë me tre oferta refuzim punësimi nga AKPA.
- Takime me IKUB në lidhje me ndërveprimin e sistemit të NE-së me sistemin e PAK me qëllim shmangien e përfitimeve të padrejta nga familje/Individë.
- Takime me ZVRPP lidhur me ndërveprimin e sistemeve mbi pronësinë.
- Takim me IKUB, AKSHI lidhur me krijim e një moduli në sistem për familjet të cilat kanë mbi 5-vite përfitimi në skemë.

1.5 Problematika në lidhje me Sistemin e Menaxhimit të Ndhmës Ekonomike

- Aksesimi i raporteve është vetëm në formatin vieë, pdf dhe ëord. Të gjithë raportet për të gjithë përdoruesit nuk mund të shkarkohen në formatin excel. Nuk janë krijuar raporte të tjera statistikore, që të shërbenin për qëllime statistikore, duke qenë se raportet nuk shkarkohen dot në excel. Gjithashtu ka dhe raporte të tjera të nevojshme , për të cilat nuk është dhënë akses për asnjë nga përdoruesit, siç është raporti “Anëtarë në moshë aktive pune të familjeve përfituese” apo “Përfituesit PAK”, “Anëtarët e referuar në AKPA”, “Aplikimet regjistruar, përfitues, refuzuar”, “numri i fëmijëve sipas grup moshave”, etj.
- Për shkak të moslejimit të copy-paste në sistem, nuk mund të kopjohet arsyeja e detajuar e mospërputhjes e ardhur nga ndërveprimi i sistemeve në panelin e verifikuesit dhe vendimmarrësit, gjatë trajtimit të mospërputhjeve apo refuzimit të aplikimit. Një zgjidhje e sugjeruar ka qenë që të përdorin një arsye standarte sipas intitucioneve nga vjen mospërputhja.
- Konstatuar problematikë në lidhje me vendimmarrjen pasi nuk përputhej vendimi final i Drejtorisë me borderonë nga sistemi. Problematika është raportuar tek kompania e mirëmbajtjes.
- Kërkuar IKUB të ndërtohet nje raport në lidhje me referimet e kryera në AKPA sipas statusit anëtarë në moshë aktive pune që nuk janë PAK, nuk rezultojnë të punësuar, nuk janë studentë dhe që jetojnë në zona rurale. Raporti është implementuar, dhe aktualisht aksesohet vetëm nga suporti qëndror.
- Konstatuar problematika me fondin 6 % lidhur me riaplikimet në sistemin e NE, ka pasur raste që kanë pasur vështirësi riaplikimi pasi kanë marrë statusin rekomanduar, duke mos qenë rekomaduar për muajin respektiv. Gjithashtu problem janë rastet kur

duhet të riaplikojë në sistem, por duke qenë se sistemi nuk lejon të kesh aplikim me statusin rekomanduar apo përfitues, aplikuesit në rast riaplikimi në sistem, duhet të humbin një muaj përftimi 6%, pavarësisht se refuzohen nga sistemi. Aplikimet e fondit 6 % nuk verifikohen automatikisht, në momentin që vazhdojnë të jetë përfitues të fondit 6 %, duke bërë që të kenë periudha të gjata mosverifikimi.

Integrimi, orientimi dhe punësimi i anëtarëve në moshë aktive pune të përfituesve të NE-së drejt tregut të punës

Me qëllim transformimin e programit të NE në një skemë integrimi nëpërmjet krijimit të mundësive për punësim, në kuadër të zbatimit të VKM-së Nr.882, datë 24.12.2019 “Për mekanizmin e bashkërendimit ndërinstitucional të punës për referimin për punësim të individëve dhe anëtarëve në moshë aktive pune, të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike”, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë në vijim të dy Urdhërave të Përbashkët përkatësisht, Urdhër i Përbashkët Nr.52, datë 26.01.2022 “Për miratimin e mekanizmit të referimit për punësimin dhe integrimin social të individëve në moshë aktive pune” si dhe Urdhër i Përbashkët Nr.148, datë 28.02.2022 “Për ngritjen e grupeve rajonale të punës për vlerësimin, referimin për punësim dhe integrimin social të anëtarëve në moshë aktive pune të skemës së ndihmës ekonomike”, ka nxjerë dhe Urdhër i Përbashkët Nr.85, datë 15.02.2023 për një ndryshim në Urdhërin Nr. 52, datë 26.01.2022 “Për miratimin e mekanizmit të referimit për punësimin dhe integrimin social të individëve në moshë aktive pune”.

Në vijim të Urdhërit Nr.85, datë 15.02.2023 është realizuar ndërveprimi i sistemeve të AKPA-së dhe SHSSH për referimin e anëtarëve në moshë aktive pune, direkt nga administratori shoqëror në Zyrat e punës.

Për periudhën Janar-Dhjetor 2023 janë referuar te zyrat e punës 17000 anëtarë në moshë aktive pune , nga të cilët janë punësuar/proces ndërmjetësimi 2.449 individë të familjeve përfituese të skemës së ndihmës ekonomike dhe adresuar për formim profesional 1.061 anëtarë në moshë aktive pune. Janë larguar nga skema e ndihmës ekonomike 927 familje, anëtarët e të cilëve kanë refuzuar ofertat e punësimit. Për personat me aftësi të kufizuar janë referuar te zyrat e punës 999 individë si kategori PAK në moshë aktive pune , nga të cilët janë punësuar/proces ndërmjetësimi 43 individë dhe adresuar për formim profesional 27 individë.

Ndërkohë gjatë gjithë kësaj periudhe janë mbledhur komisionet trepalëshe dhe kanë marrë vendime lidhur me mbarëvajtjen e procesit dhe vendime lidhur me refuzimet e shërbimeve të ofruara nga zyrat e punës duke trajtuar refuzimet me arsyet përkatëse.

Aftësia e Kufizuar 2023

Kontrolle të kryera nga Drejtoria e Kontrollit të Pagesës së NE dhe PAK

Qëllimi dhe objektivat e kontrolleve janë zbatimi i legjislacionit të PAK pranë Komisioneve Shumëdisiplinore të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, plotësimi i detyrimeve nga DRSHSSH dhe OSHKSH në përputhje me

legjislacionin e aftësisë së kufizuar në fuqi. Raportet janë bazuar në hapat e përcaktuara në përputhje me Metodologjinë e Kontrollit të Vlerësimit Bio-Psiko-Social të Aftësisë së Kufizuar.

Baza ligjore ku jemi mbështetur:

Ligjin Nr.57, 18.07.2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr.257, datë 05.05.2021 “Për Proçedurat e Kryerjes së Kontrollit të Zbatimit të Legjislacionit të Asistencës Sociale”, VKM Nr. 431, datë 08.06.2016 “Për Përcaktimin e Kritereve, të Dokumentacionit, të Proçedurave, dhe të Masës së Përfitimit e Pagesës së Aftësisë së Kufizuar e të Ndihmësit Personal dhe të Strukturave Përgjegjëse e të Detyrave të Tyre në Zonat Pilot”, VKM 722, datë 11.11.2019 “Për Përcaktimin e Masës , të Kritereve, Proçedurave dhe Dokumentave për Vlerësimin dhe Përfitimin e Aftësisë së Kufizuar të Ndihmësit Personal, dhe të Strukturave Përgjegjëse e të Detyrave të Tyre ”, të ndryshuar, Metodologjinë e Kontrollit të Vlerësimit Bio-Psiko-Social të Aftësisë së Kufizuar ” si dhe Urdhërit Nr.462 datë 29.10.2021 “Për Shtrirjen e Sistemit të Vlerësimit Bio-Psiko-Social të Aftësisë së Kufizuar dhe Mekanizmin e Kontrollit dhe Monitorimit ”.

Gjatë vitit 2023 sipas planit të punës dhe **Urdhrit Nr.63 datë 08.02.2023 “ Kontrollin e skemës së vlerësimit Bio-Psiko-Social të përfituesve të aftësisë së kufizuar ”** janë kontrolluar gjithsej **19 Komisione Shumëdisiplinore të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar** pranë Drejtorive Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror **Lezhë, Shkodër, Vlorë, Korçë, Berat, Fier dhe Dibër**, përkatësisht:

Nga kontrolli i ushtruar në këto 19 Komisione Vlerësimi janë konstatuar problematika si dhe janë lënë rekomandime dhe detyra si më poshtë :

Nga kontrolli me përzgjedhje nga sistemi i **3.382 dosjeve fizike** të personave me aftësi të kufizuar pranë Komisioneve Shumëdisiplinore të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar në Drejtoritë Rajonale **Lezhë, Shkodër, Vlorë, Korçë, Berat, Fier dhe Dibër** u konstatua se në zbatim të VKM Nr.722 ,datë 11.11.2019, pika 2,3 ndodhet karta e identitetit (çertifikata personale), formulari i aplikimit, mjekut të familjes, mjekut specialist dhe formulari i vlerësimit si dhe dokumentacioni mjekësor i kërkuar sipas Udhëzuesit për Vlerësimin Bio-Psikosocial.

Në 362 dosje mungon një pjesë e dokumentacionit mjekësor të kërkuar sipas Udhëzuesit për Vlerësimin Bio-Psikosocial. Kjo në kundërshtim me Urdhërin nr. 225,datë 06.12.2019, pika 2.4, germa a, për miratimin e rregullores “ Për Organizimin të Drejtat, Detyrat dhe Funksonimin e Komisioneve Shumëdisiplinore të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar, **ku Mjeku i KSHVAK ka për detyrë të sigurojë që i tërë informacioni mjekësorë plotëson standartet për vlerësimin** dhe përcaktimin e aftësisë së kufizuar dhe nivelin e dëmtimit në përputhje me kriteret e udhëzuesëve Bio-Psiko-Socialë të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar. *Grrupi i kontrollit ka lë detyrë që të vijohet me zbatimin e detyrave mbi plotësimin e dokumentacionit për përfitimin e aftësisë së kufizuar si dhe ekzaminimet mjekësore përkatëse sipas diagnozave të përcaktuara në Udhëzuesin e Vlerësimit Bio-Psiko-Social për të rritur dhe*

fëmije.

Nga verifikimi elektronik i informacionit në Regjistrin Elektronik Kombëtar në zbatim të VKM Nr.722 ,datë 11.11.2019, kreu III, pika 4, gërma c në lidhje me ISSH dhe DPT konstatohet se me Institutin e Sigurimeve Shoqërore dhe me Drejtorinë e përgjithshme të tatimeve rezulton se ka përgjigje në sistem.

Pas verifikimeve në Regjistrin Elektronik Kombëtar u konstatua se pjesa më e madhe e individëve që rezultojnë me përgjigje (kontribute) janë përfitues sipas skemës së vjetër të aftësisë së kufizuar dhe në bazë të ligjit nr 57/2019 nuk trajtohet si shkelje.

Personat që kanë në dosjet e tyre dokumente zyrtare nga DPT të dala nga sistemi janë skualifikuar pasi konsiderohet shkelje dhe janë orientuar te skema e ISSH-së, ndërsa personat e tjerë janë kualifikuar pasi nuk përfitojnë në bazë të ligjit 7703 “Për Sigurimet shoqërore” i ndryshuar (nuk plotësojnë kriterin ligjor 12 muaj kontribute në 5 vitet e fundit), kjo e shoqëruar me shkresë zyrtare nga ISSH.

Për 32 aplikantë, nuk duhej realizuar procedura e komisionimit, pasi diagnozat nuk përfshihen në Udhëzuesin e Vlerësimit Bio-Psiko-Social, dhe 44 raste afatet e përfitimit janë përcaktuar me efekt prapaveprues.

DRSHSSH duhej të refuzonte me shkresë zyrtare aplikimet jashtë kriterëve.

Mjekët e familjes dhe mjekët specialist kanë plotësuar formularët në kundërshtim me Udhëzuesit e Vlerësimit Bio-Psiko-Social.

Dëmi ekonomik i shkaktuar në total për 76 raste është 3.272.886 Lekë.

Për rastet kur diagnoga nuk përfshihet në Udhëzuesin e Vlerësimit Bio-Psiko-Social, grupi i kontrollit ka lënë detyrë të rivlerësohen nga Komisioni Shumëdisiplinor i nivelit më të lartë në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror, bazuar në pikën (dh) të Urdhrit nr. 63, datë 08/02.2023 “Për kontrollin e skemës së vlerësimit bio-psiko-social të aftësisë së kufizuar.

Për rastet e përfitimit me efekt prapaveprues grupi i kontrollit ka lënë detyrë shpërblimin e dëmit nga zyrarët që e kanë shkaktuar (Komisionit Shumëdisiplinor të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar)

Në 80 dosje Diagnoza është hedhur gabim në sistem, pasi tjetër diagnozë ka shënuar mjeku specialist në formular dhe tjetër diagnozë është hedhur në sistem.

Grupi i kontrollit ka njoftuar Drejtoritë Rajonale në lidhje me detyrimet që ka Mjeku i zyrës së Vlerësimit Bio-Psikosocial, i cili duhet të verifikojnë dokumentacionin mjekësor të aplikantëve që në momentin e dorëzimit të dokumentacionit, të hedhë në sistem diagnozën e saktë ashtu siç e ka plotësuar mjeku specialist dhe për rastet jashtë kriterëve të përcaktuara në Udhëzuesin e Vlerësimit Bio-Psiko-Social të mos kryejnë procedurën e vlerësimit. DRSHSSH të njoftojë zyrtarisht aplikantin.

Nga kontrolli i afateve të vlerësimit të 3.382 dosjeve rezulton se janë shkelur afatet e

komisionimit për **126 aplikantë**, kjo në kundërshtim me **VKM Nr.722 ,datë 11.11.2019 i ndryshuar, Kreu III, pika 4, gërma d:**

Stafi i zyrës së vlerësimit ka këto detyra :

Organizon kryerjen e intervistës, sipas formatit 6, bashkëlidhur këtij vendimi, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes së dokumentave të aplikimit.

Grupi i kontrollit ka njoftuar Drejtoritë Rajonale në lidhje me detyrimet që ka Zyra e Vlerësimit me zbatimin e VKM Nr.722 , datë 11.11.2019 i ndryshuar, Kreu III, pika 4, gërma d: Ku stafi i zyrës së vlerësimit organizon dhe kryen intervistën brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes së dokumentave të aplikimit.

Mjeku specialist dhe mjeku i familjes duhet të përcaktoje diagnozën dhe nivelin e vështirësisë sipas udhëzuesit bio- psiko-social të mbështetur në dokumentacionin mjekësor dhe ekzaminimet mjekësore perkatatëse kjo e dokumentuar në kartelën mjeksore. **Nga kontrolli rezultoi se mungoni kartetat për 487 raste.**

Kjo në kundërshtim me VKM Nr.257, datë 05.05.2021 “Për procedurat e kryerjes së kontrollit të zbatimit të legjislacionit të asistencës sociale” pika 12, gërma c ku shprehet se:

Për vlerësimin bio-psiko-social të aftësisë së kufizuar, grupi i kontrollit në nivel qëndror kontrollon zbatimin e legjislacionit për kontrollin e procesit të referimit nga strukturat shëndetësore, përfshirë **kontrollin e kartelës shëndetësore**, përputhshmërinë e diagnozës dhe kohës së fillimit të sëmundjes me përshkrimet në formularët e referimit, referimin nëpërmjet sistemit dhe recetën elektronike.

*Grupi i kontrollit ka njoftuar **Operatorin e Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor në lidhje me detyrimet** që kanë Mjekët specialist dhe Mjekët e familjes pasi duhet të përcaktojnë diagnozën kryesore të pacientit sipas emërimit në Udhëzuesin e Vlerësimit Bio-Psiko-Social për të rritur dhe fëmijë dhe ta mbështesi këtë diagnozë mbi të gjitha ekzaminimet dhe dokumentacionin mjekësorë të përcaktuar në udhëzues, e dokumentuar në kartelën shëndetësore.*

Për 374 rastet e konstatuara me parregullsi në dokumentacion është lënë detyrë të bëhet rivlerësimi nga Komisioni Shumëdisiplinor i nivelit më të lartë të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror. *Grupi i kontrollit ka lënë detyrë të rivlerësohen nga Komisioni Shumëdisiplinor i nivelit më të lartë në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror, bazuar në pikën (dh) të Urdhrit nr. 63, datë 08/02.2023 “Për kontrollin e skemës së vlerësimit bio-psiko-social të aftësisë së kufizuar.*

Nr.	Qarku	Mungon dokumentacion i mjekësor sipas udhëzuesit	Diagnoza hedhur gabim në sistem	Diagnoza jashtë kritereve Efekt Financiar dhe efekt prapaveprues	Nuk është respektuar afati 30 ditor komisionimit	Dërgohen në KSHA për parregullsi dokumentacioni	Mungonin kartelat mjeksore OSHKSH	Muaji/viti kur ka filluar zbatimi i skemës së re	Numri I dosjeve të kontrolluara	Numri i PAK abuziv	Dëmi ekonomik	Masat e marra
1	Berat	14	17	8	5	52	58	Dhjetor 2022	310 dosje (2 komisione)	8	464,269	7 vërejtje me shkrim
2	Dibër	59	5	49	67	78	91	Janar 2023	434 dosje (2 komisione)	49	1,900,707	7 vërejtje për paralajmërim për pushim nga puna dhe Shpërblim dëmi
3	Fier	62	12	7	2	94	139	Nëntor 2022	1.010 dosje (4 komisione)	7	307,523	1 largim nga puna, 10 vërejtje me shkrim, 1 vërejtje për paralajmërim për pushim nga puna, 1 vërejtje verbale.
4	Korçë	40	5	3	2	37	66	Gusht 2022	575 dosje (3 komisione)	3	106,953	
5	Lezhë	76	19	4	2	56	31	Qershor 2022	178 dosje (2 komisione)	4	145,842	2 vërejtje me shkrim
6	Shkodër	61	16	5	48	34	69	Qershor 2022	355 dosje (3 komisione)	5	347,592	7 vërejtje me shkrim
7	Vlorë	50	6	0	0	23	33	Qershor 2022	520 dosje (3 komisione)	0	0	
8	TOTALI	362	80	76	126	374	487		3,382 dosje	76	3,272,886	27vërejtje me shkrim, 8 vërejtje për paralajmërim për pushim nga puna, 1 largim nga puna dhe shpërblim dëmi
Shënim : Gjithsej 76 dosje me dëm Ekonomik të cilat ndahen , 32 dosje jashtë kriterit mjekësor me efekt financiar 1,788,736 lek dhe 44 dosje me efekt financiar prapaveprues 1,484,150 lek												

Shënim: Gjithsej 76 dosje me dëm Ekonomik 3,272,886 lekë të cilat ndahen , 32 dosje jashtë kriterit mjekësor me efekt financiar 1,788,736 lek dhe 44 dosje me efekt financiar prapaveprues 1,484,150 lekë.

Përmirësimi i raporteve në Regjistrin Elektronik të PAK-së

- Eshtë realizuar administrimi dhe mirëmbajtja e sistemeve elektronike PAK (Vlerësimim Bio-Psokosocial) dhe Arkiva.
- Përditësime në Regjistrin Elektronik të PAK i të gjitha zyrave të vlerësimit si dhe akseset për të gjithë njësitë vendore, sipas kërkesave të bëra.
- Krijime dhe përditësime të userave me rolet përkatëse.
- Rikonfigurimet e VPN, po ashtu dhe vendosja e antivirusëve në çdo kompjuter.
- Shtimi i diagnozes S.Doën ne Bio-Psiko-Social
- Letër njoftimi KSHA
- Është shtuar vërtetim negativ në e-Albania.

Përditësimi i Arkivës Elektronike PAK

Janë bërë takime në MSHMS dhe IKUB lidhur me problematika të konstatuara të përditësimit të arkivës elektronike nga DRSHSSH dhe nga administratorët shoqërorë. Eshtë koordinuar me 12 IT ne DRSHSSH për te kryer trainime me administratorët shoqërorë lidhur me kalendarin e pagesave.

Gjatë vitit 2023 në sistemin elektronik PAK janë shtuar verifikimet për Rezidencën, moshën dhe afati i kontrollit vjetor.

II. DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE

Drejtoria e Shërbimeve Sociale ka në fokus të punës së saj zhvillimin e shërbimeve shoqërore sipas legjislacionit përkatës. Kjo drejtori bazuar në Planin e Veprimit për vitin 2023 është përpjekur të fokusohet në rritjen e cilësisë së shërbimeve sociale të ofruara për grupet vulnerabël në zbatim të strategjisë së mbrojtjes sociale.

Aktiviteti i DSHS është pasqyruar si më poshtë në bazë të objektivave të përcaktuara në planin e veprimit 2023.

1- Zhvillimi i shërbimeve sociale sipas legjislacionit.

- Gjatë vitin 2023 janë zhvilluar takime monitoruese me punonjësit e Drejtorive Sociale të Bashkive dhe Drejtorive Rajonale të SHSSH për implementimin e planeve sociale dhe zbatimin e legjislacionit në fushën sociale; Nga këto takime ka rezultuar që:
 - Në 61 bashki rezulton se 21 bashki ju ka mbaruar afati i planeve sociale Vlefshmëria e Planit Social për 21 Bashki ka mbaruar në Dhjetor të vitit 2023 dhe shumë bashki janë duke negociuar me ekspert për të rihartuar planet sociale me objektiva të reja për implementimin e tyre.
 - Janë ngritur 13 NJVNR në nivel bashkie dhe njësi administrative, konkretisht në nivel bashkie
 - Bashkitë kanë mungesë të theksuar të burimeve njerëzore për punonjës të shërbimeve sociale.
 - Nga 61 Bashki në 29 janë ngritur Drejtoritë e shërbimeve Sociale dhe 32 bashki funksionojnë si sektor social.

2- FONDI SOCIAL

Fondi Social, si një mekanizëm që mbështet financiarisht ngritjen e shërbimeve sociale në komunitet për njësitë e qeverisjes vendore, kontribuon drejtpërdrejtë në ofrimin e shportës së shërbimeve sociale për kategoritë në nevojë, bazuar në analizën e nevojave të planeve sociale të bashkive, për të zgjeruar kështu hartën e shërbimeve sociale.

Fondi Social ka bërë të mundur, ngritjen e **54 shërbimeve** të përkujdesit shoqëror nga të cilat, kanë përfituar 38 bashki dhe 8 qarqe, të ofruara nga 452 profesionistë.

Vetëm për vitin 2023, harta e shërbimeve u zgjerua me **14 shërbime të reja**, 12 shërbime komunitare në 12 bashki dhe 2 shërbime të specializuara në 2 qarqe, ku synohet të arrihet mbulimi i nevojave të më shumë se 4049 individëve dhe familjeve të tyre, me angazhimin e 122 figurave profesionale.

Janë nënshkruan marrëveshjet e bashkëpunimit midis 12 Bashkive të reja përfituese dhe SHSSH, ku palët janë angazhuar mbi detyrimet që kanë lidhur me ofrimin me cilësi dhe efikasitet të shërbimit, duke respektuar standardet, duke realizuar procesin e referimit të rastit nëpërmjet Regjistrimit Elektronik. Së fundmi, është realizuar *monitorimi i shërbimeve shoqërore* të mbështetura me Fond Social për vitin 2023, në 33 Qendrat/shërbimet/projektet.

Ndër konstatimet/shqetësimet kryesore do të veçoheshin:

- ✓ 9 qendra pa licensë

- Qendra Sociale “Motrat Qirjazi”, shërbimit ditor për të moshuar në Bashkinë Kolonjë;
 - Qendra Sociale Ditore “Nderim Brezash” në Bashkinë Belsh;
 - Qendra Ditore për të Moshuar Bashkia Prrenjas;
 - Qendra Sociale “Lulet e Diellit” Gramsh
 - Qendra Terapeutike për Fëmijë me Aftësi të Kufizuar Gjirokastër
 - Projekti “Ngritja e shërbimeve komunitare Multifunkionale për fëmijë, të rinjtë dhe familjen në Njësinë Administrative Shushicë”, Bashkia Elbasan
 - Qendra Multifunkionale për Zhvillimin e Fëmijëve dhe Fuqizim Familjeve, në B. Sarandë;
 - Shërbimi Lëvizës “Tungjatjeta Jetë” në Bashkinë Rrogozhinë;
 - “Strehëza për fëmijë pa kujdes prindëror” Bashkia Shkodër;
- ✓ 3 qendra mungesë e figurës së profesionistit në përbërje të ekipit multidisiplinar (punonjës social, psikolog, logopedist), krijuar nga largimet nga puna.
- Qendra “Strehëza për fëmijë pa kujdes prindëror” Bashkia Shkodër, nuk ka në strukturë pozicion të mirëfilltë Punonjës Social dhe mungesë të Psikologut;
 - Në Qendrën Sociale “Lulet e Diellit” Gramsh mungon specialisti Logopedist.
 - Në Qendrën e Shërbimit për Viktimat e Dhunës në familje Bashkia Gjirokastër mungon figura e punonjësit social.
- ✓ Gjatë monitorimit janë evidentuar se përgjithësisht ofrimi i shërbimit ishte në përputhshmëri me standardet e miratuara. Disa bashki nuk kanë pasur eksperiencë me parë në ofrimin e shërbimit dhe u konstatua se stafi ka nevojë për trajnime për zbatimin e standardeve.
- ✓ Bashkitë që kanë vitin e parë të financimit ose e kanë vetëm për 1 vit kanë nevojë për përmirësime në plotësimin e kushteve fizike dhe përmbushjen e standardeve për realizimin e ofrimit të shërbimit për të plotësuar nevojat e përfiutesve.
- ✓ Shërbimet e financuar ndërmjet qarkut kanë një tregues më pozitiv në ofrimin e shërbimit dhe në përmbushjen e standardeve përkatëse të tipologjisë dhe të realizimit të Fondit.

3. DINAMIKA E IPSH-VE

Në të gjithë vendin janë **28 institucione të përkujdesit shoqëror**, që ofrojnë shërbime rezidenciale dhe shërbime ditore, të cilat financohen nga buxheti i shtetit.

Konkretisht janë:

- 6 Qendra zhvillimi për PAK,
- 6 shtëpi për të moshuar,
- 9 IPSH për fëmijë,
- 2 qendra ditore për të moshuar,
- 2 qendra ditore për PAK
- 2 Qendra kombëtare për gratë e dhunuara dhe viktimat e trafikimit

- 1 Qendër kombëtare emergjence (QKTE)
- **Qendrat e Zhvillimit për PAK**

Gjatë periudhës së raportimit Janar- Dhjetor 2023 në 6 qendra të zhvillimit janë sistemuar 6 raste dhe është rikthyer në familjen biologjike vetëm 2 përfitues.

Aktualisht, në të 6 qendrat e zhvillimit për PAK marrin shërbime 194 përfitues, nga këto 103 persona mbi moshën 21 vjeç, kjo për arsye nga më të ndryshme si: braktisja e personave që në lindje, probleme sociale-ekonomike shumë të theksuara në familje, prindërit janë shumë të moshuar si dhe me probleme shëndetësore fizike, mendore dhe e kanë të pamundur të kujdesen për fëmijët.

Qëndrat e zhvillimit në Korçë, Shkodër dhe Berat kanë humbur funksionalitetin e tyre, për këtë tipologji shërbim, pasi përfituesit janë mbi moshën 21 vjeç dhe nuk mund të marrin asnjë zhvillim për aftësimin jetësor për shkak të diagnozës. Shërbimet që ofrohen në këto qendra janë të përqëndruara më shumë në shërbime jetësore si ushqim, shërbim shëndetësor dhe aktivitete kulturore.

Në këtë kontekst, propozohet ndryshimi i tipologjisë së shërbimit në këto institucione, kjo dhe për shkak të rritjes së numrit të kërkesave, pranë SHSSH, për sistemim të personave me aftësi të kufizuar mbi 21 vjeç, të cilët janë të braktisur nga familja apo kanë arsye sociale ekonomike.

Në dy Qendrat Ditore për PAK (Lezhë dhe Korçë) kapaciteti gjithësej është 64 vende. Aktualisht marrin shërbime 50 persona me aftësi të kufizuar.,

- **Shtëpitë e të Moshuarve**

Në 6 shtëpitë e të moshuarve kapaciteti gjithësej është 330 vende. Aktualisht marrin shërbim 316 të moshuar. Aktualisht në 6 shtëpi të moshuarish janë plotësuar gati 90% e kapacitetit. Kërkesat për shërbim rezidencial janë duke u rritur dhe kapacitetet vazhdojnë të jenë të kufizuara. Vërehet se kërkesat për sistemimin e të moshuarve në qendra rezidenciale janë kryesisht për persona me probleme të shëndetit mendor dhe fizik.

Për 2023 janë komisionuar 99 të moshuar. Nga të dhënat konstatohet numri më i lartë i hyrjeve (99), krahasuar me numrin e daljeve, përfshirë dhe rastet kur përfituesi ka ndërruar jetë (68 raste me vdekje).

Në dy Qendrat Ditore për të Moshuar (Kamëz dhe Sarandë) kapaciteti gjithësej është 85 vende. Aktualisht marrin shërbime 81 të moshuar.

- **Institucionet rezidenciale të përkujdesit për fëmijë**

Në 9 institucionet rezidenciale publike trajtohen **164 fëmijë** (nga këto 121 fëmijë janë vendosur në kujdestari ligjore të IPSH-ve, me vendim Gjykate) rezidencial dhe 27 ditor.

Në këto qendra aktualisht shfrytëzohet pak më shumë se 50% të kapacitetit, kjo dhe për shkak të moratoriumit që është zbatuar në dy qendrat Korçë dhe Vlorë, apo numrit të ulët të pranimeve

gjatë viteve të fundit, duke i dhënë prioritet fuqizimit të familjes dhe parandalimit të institucionalizimit të fëmijëve, në kuadër të procesit të DEI. **Ndryshe nga viti 2022 kemi ulje të numrit të fëmijëve me rreth 20 % në 9 IPSH-të publike.**

Gjatë vitit 2023 janë pranuar **21 fëmijë** në institucionet rezidenciale publike të vlerësuar si rast emergjente nga **GTN (Grupet Teknike Ndërsektoriale)** dhe janë ndjekur procedurat sipas protokolleve të mbrojtjes së fëmijëve deri vendoje në kujdestari ligjore me vendim gjykate. Gjatë vitit janë ndjekur rreth 34 seanca Gjyqësore për vendosjen e fëmijëve në kujdestari të institucioneve.

Janë integruar në jetesë të pavaruar 8 të rinj nga Shtëpia Rinore Shkodër duke u punësuar në biznese të ndryshme.

Janë birësuar 24 fëmijë, ndërkohë që numri i rikthimeve në familje biologjike (**18 fëmijë të rikthyer në familje**) është ulur krahasuar me vitet më parë për shkak të vendosjes së fëmijëve me masë mbrojtje me vendim gjykate (marrja e kujdestarisë nga institucionit), duke vështirësuar daljen për shkak të zgjatjes dhe afateve të vendimeve gjyqësore, si dhe vështirësitë për fuqizimin e familjeve biologjike për arsye të ndryshme sociale - ekonomike. Në kuadër të deinstitutionalizimit është arritur këtë vit të kalojë në(familje kujdestare foster-care) 1 fëmijë.

Numri i pranimeve të fëmijëve në institucione rezidenciale ka trend ulës, si rezultat i uljes së braktisjes së fëmijëve që në lindje (në maternitet).Gjatë vitit rezultojnë fëmijë të braktisur në maternitet, 10 fëmijë.

Nga të dhënat e raportuar fëmijë të tjerë të vlerësuar pa interesim sipas afateve kohore 1 vit e më shumë janë **40 fëmijë**.

➤ **Statusi i Jetimit**

- Lidhur me statusin e jetimit e kanë përfituar statusin 211 persona nga të cilët 29 persona të cilët nuk i kane të dy prindërit, 182 persona janë të lindur jashtë martesë dhe 1 person i është hequr e drejta prindërore me vendim gjykate. Gjithashtu janë rinovuar rreth 300 statuse.
- Ka nisur funksionimi on-line i aplikimeve të statusit të jetimit në sistemin elektronik AMS dhe SQDNE, Sistemi i Qarkullimit të Dokumentave me Nënshkrim Elektronik. Gjithsej kanë aplikuar për këtë shërbim **50 raste**.

➤ **Qendrat e Dhunës në Familje dhe Trafikimit**

Janë trajtuar raste dhune dhe trafikimi të trajtuara gjithsej janë 80 raste viktime dhune (36 gra +44 fëmijë) dhe 15 raste viktime trafikimi. Për të gjitha rastet është bashkëpunuar me pushtetin lokal për integrimin e tyre në komunitet.

➤ **PROBLEMATIKAT/ REKOMANDIMET E HASURA GJATË PROCESIT TË MONITORIMIT**

- Mungesa e shërbimeve për fëmijë/adult mbi 21 vjec me aftësi të kufizuar dhe për të moshuar sjell vështirësi në menaxhimin e rasteve dhe trajtimi i tyre sipas nevojave që referojnë nga njësitë e pushtetit vendor;
- Mungesa e pajisjeve (shtretër ortopedikë) dhe elementeve të aksesueshmërisë për të moshuarit PAK dhe të rënduar fizikisht.
- Mungesa e një institucioni përkujdesi shoqëror i specializuar për trajtimin e raste me problematika të shtuara/rënda shëndetësore kryesisht të shëndetit mendor, me struktura të dedikuara shëndetësore me kohë të plotë;
- Mungesa e metodologjisë së monitorimit
- Qarkullimi i stafëve dhe mos emërimet e punonjësve në IPSH-të e fëmijëve, në kohë nga Bashkia, ka sjelle vështirësi në menaxhimin dhe ofrimin e shërbimit në këto institucione;
- Mungesa e investimeve në përmirësimin e kushteve fizike të godinave kryesisht në Institucionet me kapacitet me të madhe si, Shtëpitë e fëmijëve 6-15 vjeç Sarandë dhe Tiranë dhe Shtëpia e fëmijës 16-18 vjeç Shkodër, të cilat kanë shfaqur konsumim dhe amortizim gjatë këtyre viteve.
- Në tre Shtëpi Fëmijë 0-5 vjec Durrës, Shkodër dhe Sarandë është përfshirë dhe shërbimi ditorë për fëmijë. Aktualisht numri i fëmijëve në shërbim ditor në këto institucione është ulur afërsisht 50%, për mungesë të stafit.
- Qendrat e zhvillimit që ofrojnë shërbime rezidenciale për personat me AK kanë nevojë jo vetëm në infrastrukturë por edhe në përditësimin e programve specifike që duhen të ofrohen në institucion për përfituesit sipas diagnozave që kanë. Nga monitorimet është parë e nevojshme për shtim të stafit specialist përgjegjës për përmisimin e aftësive jetësore për përfituesit.

4. DIXHITALIZIMI I SHËRBIMEVE SOCIALE DHE REGJISTRI ELEKTRONIK I SHËRBIMEVE SHOQËRORE

Hartëzimi i Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror krijon një pasqyrë të plotë jo vetëm mbi tipologjinë dhe llojin e shërbimeve, por edhe rolin e tyre në plotësimin e nevojave shoqërore të përfituesve të shërbimeve. Nga ky studim rezulton se sot ofrohen shërbime në 391 institucione përkujdesi ose 16% më shumë se sa në vitin 2021(339 institucione). Këto institucione sigurojnë 1,147 shërbime ose 2,3 herë më shumë se sa në vitin 2021.

Ndërsa institucionet “Jo-Publike” përbëjnë 39% të numrit të përgjithshëm, duke siguruar 46% të të gjitha shërbimeve për 62% të përfituesve, institucionet e tipit të “përzierë” përbëjnë 31% të numrit të përgjithshëm dhe sigurojnë 46% të shërbimeve për 18% të përfituesve dhe institucionet publike përbëjnë 30% të numrit të përgjithshëm, nga të cilët përfitojnë 19% e individëve në nevojë.

Harta do të jetë pjesë e regjistrimit elektronik të shërbimeve, që do t'i shërbejë procesit të referimit të rasteve.

Monitorimi mbi ecurinë e funksionimit të regjistrit elektronik të shërbimeve shoqërore për gjatë vitit 2023 ka nisur punën në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Drejtorinë e IT në perpilimin e një listë të saktë me të gjithë përdoruesit e sistemit, qofshin këta përdorues ekzistues në sistem, të cilëve iu është rivendosur passëord si dhe janë hapur usera te rinj për të gjithë punonjësit e rinj te emeruar së fundmi. Në total numërohen **446 usera** aktiv në sistem.

Për sigurimin dhe zbatimin e përdorimit të plotë të regjistrit elektronik të shërbimeve shoqërore, janë zhvilluar takime dhe trajnime në pjesën më të madhe të bashkive për gjithë periudhën e vitit 2023. Aktualisht hedhja e rasteve në regjistrin elektronik të shërbimeve shoqërore është arritur në shumë Bashki. Duke u bazuar në raportin e gjeneruar nga sistemi i SHKSH, numri total i rasteve të hedhura në sistem është **3269** raste nga këto **228** kanë përshkruar të gjithë ëorkfloë-n e sistemit. Në vitin 2023 sistemi i SHKSH është populluar me **784** raste për 61 bashki. Bashkitë të cilat janë aktive dhe kanë populluar sistemin janë **Tiranë, Kamëz, Vorë, Dimal, Polican, Bulqizë, Klos, Durrës, Shijak, Krujë, Belsh, Gramsh, Librazhd, Prrenjas, Fier, Lushnje, Këlcyrë, Gjirokastër, Memaliaj, Tepelenë, Devoll, Kolonjë, Pogradec, Maliq, Kurbin, Lezhë, Mirditë, Pukë, Shkodër, Delvinë, Sarandë, Selenicë, Vlorë.**

Sfida më e madhe ngelet koordinimi në vazhdim me pushtetin vendor për mirëfunksionimin e regjistrit elektronik të shërbimeve shoqërore dhe popullimi periodik i tij. Gjithashtu Drejtoria e Shërbimeve Sociale do të ketë në fokus edhe popullimin e Regjistrit Elektronik nga IPSH-të publike dhe jopublike për rastet ekzistuese që marrin shërbime në qendra.

5. DEINSTITUCIONALIZIMI

Ecuria e procesit të De- institucionalizimit gjatë vitit 2023

Në përputhje me planin Kombëtar të Deinstitutionalizimit miratuar me VKM nr. 706 datë 01.09.2020 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Deinstitutionalizimit , 2020-2022 , Vendim nr. 01.datë 31.01.2023 “Për miratimin e vijimësisë së Planit të Veprimit për Zbatimin e Planit Kombëtar të DI për vitin 2023, dhe të planit të veprimit të zbatimit të tij:

Bazuar në planin e transformimit për institucionet e përkujdesit shoqëror pilot Bashkia Vlorë dhe Korçë u ngritën grupet e punës dhe janë bërë vlerësimet për fëmijët , vlerësimet e stafit dhe infrastrukturës së këtyre institucioneve.

Aktualisht në Shtëpinë e Foshnjës në Vlorë marrin shërbim 3 fëmijë dhe në Shtëpinë e Foshnjës Korçë marrin shërbim 3 fëmijë.

Proçesi i DI është duke avancuar me ngritjen e dy shërbimeve të reja pilot për fuqizimin e familjes dhe kujdesit alternativ në Bashkitë Tiranë dhe Durrës.

Gjatë muajit dhjetor 2023 janë kryer trajnime mbi “Procesin e Deinstitutionalizimit të fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit shoqëror , baza ligjore, bashkëpunimi ndërinstitutional, praktikat e sukseshme dhe sfidat, me stafet e institucioneve te perkujdesit shoqëror “Shtëpia e Foshnjës 0-5 vjeç Tiranë , Shtëpia e fëmijës “Zyber Hallulli” Tiranë si dhe Shtëpia e Foshnjës 0-5 vjeç Durrës. Gjithsej janë trajnuar 66 punonjës të këtyre 3 institucioneve.

SFIDAT

- Transformimi i plotë i dy institucioneve për fëmijë në Korçë dhe Vlorë në ofrimin e shërbimeve me bazë komunitare;
- Avancimi i procesit të Deinstitutionalizimit në institucionet për fëmijë dhe PAK;
- Koordinimi në vazhdim me pushtetin vendor për mirëfunksionimin e rregjistrit elektronik të shërbimeve shoqërore dhe popullimi periodik i tij.
- Ngritja e shërbimeve për fëmijë/adult mbi 21 vjec me aftësi të kufizuar dhe për të moshuar sjell vështirësi në menaxhimin e rasteve dhe trajtimi i tyre sipas nevojave që referojnë nga njësitë e pushtetit vendor
- Popullimi i Regjistrit Elektronik nga IPSH-të publike dhe jopublike për rastet ekzistuese që marrin shërbime në qendra.

III. DREJTORIA E KOMISIONIMIT TË PAK

Objektivi kryesor i përfaqësuesve të SHSSH në komisione është respektim i legjislacionit dhe kriterëve mjekësore gjatë procesit të administrimit dhe komisionimit të PAK. Aktiviteti kryesor i kësaj drejtorie është ndjekja e ecurisë së komisionimeve të PAK në KMCAE-et e Nivelit të Parë, komisionimi në KMCAE Epror i personave që ankimojnë vendimet e KMCAE-eve të Nivelit të Parë, si dhe komisionimi sipas modelit Bio-Psiko-Social.

Të dhënat për përfituesit nga skemat e aftësisë së kufizuar janë si më poshtë:

Viti	PAK	Kujdestarë	PTP	Kujdestarë	Të Verbër	Kujdestarë
2023	53636	9102	5857	5811	12982	3427

1. Skema e vlerësimit biopsikosocial

Vlerësimi biopsikosocial i aftësisë së kufizuar, është një reformë që u ndërmor në kuadër të detyrimeve që i burojnë shtetit Shqiptar nga ratifikimi i Konventës së OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, e cila që nga Janari 2023 është shtrirë dhe po zbatohet në shkallë vendi.

Vlerësimi biopsikosocial fillimisht ka nisur në vitin 2017 me pilotimin në dy njësi administrative të bashkisë Tiranë përkatësisht në njësinë 6 dhe 7. Më pas në dhjetor 2019 është shtrirë në gjithë qarkun e Tiranës. Në fund të vitit 2021 filloi të aplikohet vlerësimi biopsikosocial në qarqet Elbasan dhe Durrës duke vazhduar në qershor 2022 në qarqet e Vlorës, Shkodrës, Lezhës dhe Korçës dhe në fund të vitit në Fier e Berat. Në janar 2023 vlerësimi ka filluar dhe në qarqet Gjirokastër, Dibër dhe Kukës duke përmbyllur kështu shtrirjen e reformës në të gjithë territorin e vendit. Gjithsej funksionojnë 37 komisione biopsikosociale të vendosura pranë qendrave shëndetësore/spitaleve përkatësisht: 6 komisione në Tiranë, 3 në Durrës, 6 në Elbasan, 3 në Shkodër, 2 në Lezhë, 3 në Korçë, 3 në Vlorë, 4 në Fier, 2 në Berat, 1 në Gjirokastër, 2 në Dibër dhe 2 në Kukës. Gjithashtu pranë Drejtorisë të Përgjithshme me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm janë ngritur 3 komisione të shqyrtimit të ankesave të cilët shqyrtojnë ankesat e ardhur nga të gjithë komisionet nëpër qarqe.

Problematikat e hasura gjatë punës së komisioneve

- Problematikë mbetet paqëndrueshmëria e mjekëve nëpër komisione, nga 37 mjekë që duhet të jenë me kohë të plotë 28 janë me kohë të pjesshme pasi janë mjekë të cilët punojnë në qendra shëndetësore të ndryshme.
- Plotësimi jo i saktë i formularëve nga mjekët specialistë, ka raste të reja që vijnë me diagnoza që nuk përfshihen në udhëzuesin e vlerësimit biopsikosocial të orientuar nga mjekët specialistë, në këto raste mjekët nuk duhet të plotësojnë formularin por të sqarojnë qytetarët që kjo diagnozë nuk përfshihet në udhëzuesin e vlerësimit biopsikosocial.

- Sjellja e formularëve pa ekzaminime/konsulta mjekësore siç e përcakton udhëzuesi i vlerësimit biopsikosocial, mjekët nuk i bashkëngjisin ekzaminimet që kërkohen sipas diagnozave përkatëse, kjo sjell vonesa në komisionime dhe sorollatje të qytetarëve. Për të përmirësuar punën janë bërë takime me mjekët specialist nga ana e drejtorive rajonale të SHSSH.
- Komisionet e vlerësimit hasin probleme me personat që kanë diagnozë e cila nuk përfshihet në udhëzuesin e vlerësimit biopsikosocial: diagnoza që kanë qenë te kriteret e vlerësimit të skemës së vjetër (p.sh.: diabet melitus tip 1, epilepsi, prapambetje mendore e lehtë me çrregullim të sjelljes); diagnoza që janë te kriteret e fëmijëve por jo te të rriturit; diagnoza të cilat janë gjenetike (të rralla) nuk janë përfshirë në udhëzues, duhet një rishikim i udhëzuesit për zgjidhjen e këtyre problematikave.
- Problematikë mbetet mosdhënia e paketës higjienosanitare për arsye se nuk është bërë ende kostimi financiar dhe mënyra se si do të jepet, në pagesë kesh apo në materiale.

Të dhënat mbi numrin e personave të komisionuar me vlerësimin biopsikosocial

Viti	Intervistuar	Përfitues	Ndihmësit personal të herëpashershëm	Ndihmësi personal të përhershëm	Refuzuar
2023	38434	33624	3671	678	4810

Duke qenë se vlerësimin e ri tashmë qytetari orientohet dhe drejt shërbimeve të ndryshme (fizioterapi, logopedi, këshillim/psikoterapi, mundësi punësimi/kurse profesional etj.), pra nuk kufizohet vetëm në pagesën monetare që merrte me skemën e vjetër. Tashmë janë lidhur marrëveshjet e bashkëpunimit me të gjitha bashkitë si dhe me 12 drejtoritë rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimin dhe Aftësive. Pjesa më e madhe e bashkive nuk mund të ofrojnë shërbime për personat me AK edhe pse komisionet lënë rekomandime për shërbime të ndryshme si logopedi, fizioterapi, këshillim/psikoterapi, Shërbimet e punësimin /Trajnim profesional, Shërbime të edukimit special, trajnim për gjuhën e shenjave. Edhe në ato bashki ku mund të ketë një shërbim është e pamundur që të marrin shërbim të gjithë qytetarët pasi me së shumti janë shërbime ditore për fëmijë, **mungojnë shërbimet për personat mbi 18 vjeç** me aftësi të kufizuar sidomos për diagnozat e shëndetit mendor.

Nga janari deri në dhjetor të dhënat për rekomandimet e shërbimeve janë si më poshtë:

Referuar Shërbime Sociale	Përfitues	Referuar Arsim	Përfitues	Referuar Punësim Formim	Përfitues
5768	585	748	180	2400	161

2. Skema e vjetër / KMCAP

KMCAP-et e nivelit të parë deri në fund të muajit mars 2023 kanë komisionuar të gjitha dosjet e ardhura për komisionim për herë të parë dhe rikomisionim. Në total kanë qenë 9 KMCAP të nivelit të parë, për shëndetin mendor për shkak të numrit të madh të dosjeve kanë funksionuar

3 komisione.

Në funksionim për nivelin e parë janë vetëm KMCAP të cilët vlerësojnë dosjet e personave që kërkojnë statusin e paratetraplegjikut dhe të të verbrit.

Janë 5 KMCAP Epror, 2 sëmudjet e përgjithshme, 1 shëndet mendor, 1 verbëri dhe 1 neurologji/PTP.

Numri i dosjeve të komisionuara nga KMCAP Niveli i parë dhe Epror për periudhën Janar 2023 e në vazhdim është si më poshtë:

Nr	KMCAP Niveli I parë	Komisionuar	Përfitues	Jo përfitues
1	Shëndet Mendor	3890	3692	198
2	Sëmudjet interne	422	343	79
3	Kardiologji Ad-Hoc	156	136	20
4	OOKR	214	177	37
5	Ortopedi Ad-Hoc	1178	951	227
6	Neurologjia/PTP	1692	528	2220
7	Verbëri	2471	1702	4173

KMCAP niveli i parë për statusin e PTP ka vlerësuar 871 dosje të rekomanduara për rivlerësim nga grupi i kontrollit të dosjeve të përfituesve të statusit të para/tetraplegjisë. Nga të cilat 541 janë përfitues të grupit të parë dhe të paketës higjienosanitare, 47 grupi i parë pa paketë higjienosanitare, 23 pa grup, 201 me divergjencë dhe 59 kanë kaluar nga status në PAK.

Nr	KMCAP EPROR	Komisionuar	Përfitues	Jo përfitues
1	Shëndet Mendor	372	264	108
2	Sëmudjet interne	1858	1152	706
6	Neurologjia/PTP	1122	692	430
7	Verbëri	1192	1090	102

IV. DREJTORIA E FINANCËS DHE STATISTIKËS

Drejtoria e Financave dhe Statistikës në Shërbimin Social Shtetëror ka për **MISION** zbatimin e politikave, legjislacionit të ndihmës ekonomike, pagesës për personat me aftësi të kufizuara dhe shërbimet shoqërore për:

- 30 Institucione të Përkujdesit Shoqëror,
- 12 Zyra Rajonale,
- Agjencinë Shtetërore të Mbrojtjes së Fëmijëve,
- Administratën Qendrore të Shërbimit Social Shtetëror,
- 61 Njësi Administrative.


Gjatë vitit 2023 nga ana e DFS janë vendosur disa **OBJEKTIVA** të cilat bëjnë të mundur mbarëvajtjen e punës dhe realizimin në kohë dhe me cilësi të detyrave.

OBJEKTIVAT 2023


- Mirë-menaxhimi i fondeve buxhetore
- Mirë-menaxhimi i aseteve
- Bonusi i bebes
- Programi i Grave të Papuna
- Transparencë e plotë e shpenzimeve
- Korrupsion zero
- Zbutja dhe lehtësimi i varfërisë
- Zhvillimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror

Bazuar në raportimin periodik statistikorë, më poshtë paraqitet numri i familjeve, pjesë e skemës së NE dhe situata e fondeve për vitet 2022-2023.

Tregues: Numri mesatar i familjeve pjesë e skemës së Ndihmës Ekonomike për vitet 2022-2023 (pa përfshirë individët dhe 6%).




Siç shihet nga grafiku nga viti 2022 me 2023, kemi rënie të numrit të familjeve përfituese të NE.



Grafik nr.2: Krahassimi i numrit të familjeve në skemën e NE sipas Qarqeve 2022-2023.

Tregues: Fondi për familjet pjesë e skemës së Ndhmës Ekonomike për vitet 2022-2023 (pa përfshirë individët dhe 6%).

- Për vitin 2022 4,543,813,663 lekë
- Për vitin 2023 4,812,149,017 lekë




Grafik nr.3: Fondi për familjet pjesë e skemës së NE 2022-2023

Nëse krahasojmë fondin e shpenzuar në 2022 me 2023 referuar familjeve përfituese të NE, shohim që fondi është rritur edhe pse se numri i familjeve përfituese të NE është në zbritje. Kjo ka ndodhur për shkak të zbatimit përgjatë 2022 të dy vendimeve (nr.869, datë 29.12.2021 dhe 617, datë 22.09.2022) për ndryshimin e masës mujore të përfitimit të NE.

Tregues: Numri mesatar i individëve pjesë e skemës së PAK për vitet 2022-2023 (pa përfshirë kujdestar dhe invalid pune)


- Për vitin 2022 70,208 persona me AK
- Për vitin 2023 72,474 persona me AK



Grafik nr.4 : Numri mesatar i përfituesve në skemën e PAK


Tregues: Fondet e shpenzuara për skemën e PAK

- Për vitin 2022 14,337,296,149 lekë
- Për vitin 2023 15,154,404,106 lekë



Grafik nr.5 : Fondet e shpenzuara për individët në skemën e PAK


Më poshtë numri i personave me aftësi të kufizuar gjatë 2023 për secilin qark i krahasuar me vitin 2022.



Grafik nr.6 : Krahasimi i numrit të personave me aftësi të kufizuar sipas Qarqeve.

Invalidët e punës

- Për vitin 2022 72,790 invalidë pune
- Për vitin 2023 72,484 invalidë pune



Grafik nr.7: Numri mesatar i invalidëve të punës


Numri i invalidëve të punës ne vitin 2023 është ulur me 306 persona, në krahasim me vitin 2022.

Shënim: Analiza vjetore 2023 për **statistikat zyrtare** paraqitur më lartë, të familjeve në skemën e Ndhmës Ekonomike dhe PAK bazohet në të dhënat vjetore.

Realizimi sipas zërave të buxhetit paraqitet si më poshtë:

Tregues: Financimet në lekë nga Buxheti i Shtetit/Kontributet me fonde të buxhetit të shtetit për të gjitha llogaritë në vite:


- 2022 27.976.830.300 lekë
- 2023 30,600,443,687 lekë



Grafik nr 8: Akordimi i fondeve në total për të gjitha llogaritë për vitet 2022-2023

Tregues: Ecuria e fondeve duke përfshirë të gjithë komponentët e skemës së NE llogaria 606


- Për vitin 2022 6,663,410,724 lekë ose 99.26%
- Për vitin 2023 5,987,103,044 lekë ose 96%



Grafik nr 9: Realizimi i fondeve për llogarinë 606 NE

Tregues: Ecuria e fondeve duke përfshirë të gjithë komponentët e skemës së PAK llogaria 606

- Për vitin 2022 18,430,117,167 lekë ose 99.43%
- Për vitin 2023 18,349,195,850 lekë ose 98%




Grafik nr. 10: Realizimi i fondeve për llogarinë 606 PAK

Realizimi sipas zërave të buxhetit paraqitet si më poshtë:

A. Realizimi i fondeve të shpenzuara për llogarinë 600 paga është:

- 2022 512,114,406 lekë ose 99.41 %
- 2023 676,492,664 lekë ose 99.5%




Grafik nr. 11: Akordimi i fondeve për llogaritë 600 për vitet 2022-2023

Realizimi i fondeve për llogarinë 600 është në masën 99.5%, ky koeficient i lartë tregon mirëmenaxhimin të kësaj llogarie.

B. Realizimi i fondeve të shpenzuara për llogarinë 601 Sigurime Shoqërore është:

- 2022 85,587,268 lekë ose 98.22 %
- 2023 112,393,888 lekë ose 98%




Grafik nr. 12: Akordimi i fondeve për llogaritë 601 për vitet 2022-2023

Realizimi i fondeve për llogarinë 601 është në masën 98 %, shkon në proporcion me realizimin e plotë të fondit të pagave.

C. Realizimi i fondeve të shpenzuara për llogarinë 602 shpenzime operative është:

- 2022 300,359,760 lekë ose 98.51%

➤ 2023 331,025,964 lekë ose 99.7%




Grafik nr. 13: Akordimi i fondeve për llogaritë 602 për vitet 2022-2023

Realizimi i fondeve për llogarinë 602 është në masën 99.7%, ky koefiçient i lartë tregon mirëmenaxhimin të kësaj llogarie.

D. Realizimi i fondeve të shpenzuara për llogarinë 606 Fond për financimin e Shërbimeve të përkujdesit në Bashki e Qarqe është:


➤ 2022 158,818,000 lekë ose 82%
 ➤ 2023 176,293,132 leke ose 89%



Grafik nr. 14: Ecuria e fondeve për financimin e shërb.përk. në Bashki dhe Qarqe

E. Realizimi i fondeve të shpenzuara për llogarinë 231 Investime është:


➤ 2022 0 lekë ose 0 %
 ➤ 2023 3,248,601 leke ose 97%



Grafik nr. 15: Akordimi i fondeve për llogaritë 231 për vitet 2022-2023

F. Realizimi i fondeve të shpenzuara për programin Grate e Papuna është:

- 2023 779,824,320 leke ose 97%




Grafik nr. 16: Akordimi i fondeve për Grate e Papuna per vitin 2023

Realizimi i fondeve për programin e Grave te Papuna është në masën 97%, ky koefiçient i lartë tregon mirëmenaxhimin të kësaj llogarie.

G. Realizimi i fondeve të shpenzuara për Bonusin e Bebes per femijet e lindur jasht vendit dhe ne spitalet private është:

- 2022 21,267 çeqe
- 2023 23,040 çeqe
- Fondi Total* 2022 3,100,000,000 lekë
- Fondi Total* 2023 3,305,516,000 lekë



Grafik nr. 16: Akordimi i fondeve për bonusin e bebes 2022-2023

Vihet re një rritje e bonusit të bebes për fëmijët e lindur jashtë vendit dhe në spitalet private me 1,773 çeqe.

****Fondi Total përveç lindjeve jashtë vendit dhe në spitale private, përfshin dhe lindjet në spitale shtetërore në Republikën e Shqipërisë.***

PROBLEMATIKAT:

Ndërkohë gjatë vitit 2023 problematikat kanë qenë të shumta, më poshtë disa prej tyre:

- Akordimi i fondeve kundrejt bashkive ose qarqeve gjatë vitit, për financimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror dhe mospërdorimi i plotë nga ana e tyre, sidomos për kontratat e lidhura në mes të vitit. Gjë e cila solli mospërdorim të fondeve në fund të vitit 2023.
- Plotësimi i pasaktë i formularëve statistikor të dërguar pranë SHSSH nga Drejtoritë Rajonale, sjell vështirësi nga ana jonë për mbylljen e analizave statistikore periodike në afatin e duhur, duke na detyruar të kërkojmë informacion shtesë.
- Mungesa e udhëzimit të ri në mbështetje të V.K.M. Nr.617, datë 20.10.2021 për treguesit statistikorë të NE, PAK dhe Shërbimeve Sociale, sjell mungesën e informacionit të detajuar për monitorimin e plotë të këtyre tre programeve.
- Lidhur me shpërndarjen e bonusit të bebes SHSSH ka hasur disa problematika në lidhje me heqjen e bonusit të bebes për fëmijët e lindur jashtë territorit të Shqipërisë. Ndryshimin i VKM nr 824 dt 28.12.2023 dhe ligji nr 79/2023 përfitues të bonusit janë vetëm prindi/prinderit që kanë jetuar 180 ditë në Shqipëri. Problematika lidhet me formularin e vetdeklarimit pranë Drejtorisë së Kufirit dhe Migracionit.

PROPOZIM

- Publikimi i udhëzimit të ri në mbështetje të V.K.M. Nr.617, datë 20.10.2021 për treguesit statistikorë të NE, PAK dhe Shërbimeve Sociale për të shmangur problematikat e paraqitura më sipër.
- Unifikimi i formularëve të dërguara për NE, PAK dhe Sherbimet Sociale dërguar në DPSHSSH nga DR.
- Komunikim i vazhdueshëm me drejtorite Rajonale si dhe IPSH mbi fondet e shpenzuara në mënyrë që të evidentohen problematikat dhe të mos ketë djegie të fondeve në fund të vitit.

V. DREJTORIA E SHËRBIMEVE TË BRENDSHME

Synimi i Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme është menaxhimi efektiv i burimeve njerëzore dhe materiale me qëllim mbarëvajtjen e punës sipas legjislacionit në fuqi dhe sigurimin e kushteve për realizimin e misionit të SHSSH. Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme ka ushtruar veprimtarinë në përputhje me planin e veprimit të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm në tri sektorët e saj si më poshtë.

I. SEKTORI I SHËRBIMEVE TË BRENDSHME

Objektivi I: Menaxhimi i burimeve njerëzore

Gjatë vitit 2023 rezultatet konkrete të Sektorit të Shërbimeve të Brendshme në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore janë si më poshtë vijon:

Veprimtaria	Viti 2023
Emërime	160
Lirime	60
Procedura disiplinore	14
Shpallje e vendeve vakante	70

Në mënyrë krahasimore me vitet e mëparshme numri i lirimeve është ulur dhe pjesa më e madhe e tyre janë realizuar me vullnetin e vetë punonjësve. Një nga sfidat më të mëdha në menaxhimin e burimeve njerëzore për Shërbimin Social Shtetëror për vitin 2024 është qëndrueshmëria e stafeve të KVSHAK (kryesisht e mjekëve).

II. SEKTORI JURIDIK

Objektiv I: Përfaqësimi gjyqësor në seancat gjyqësore në të cilat Shërbimi Social Shtetëror është palë e paditur.

Gjatë vitit 2023 Sektori Juridik ka realizuar përfaqësimin gjyqësor në disa çështje në të cilat SHSSH është palë e paditur. Konkretisht:

- Është përfaqësuar institucioni dhe janë përgatitur prapësimë/deklarata mbrojtje për 17 çështje gjyqësore të cilat kanë pasur si objekt kryesisht anullimin/shfuqizimin e vendimeve të KMCAP-eve dhe KSHA-s. Dy nga çështjet gjyqësore lidhen me posedimin/administrimin e Godinave nr.1 dhe 3 në Golem ku aktualisht ofron shërbimin Qendra e Zhvillimit “Pëllumbat”.
- Për një nga çështjet gjyqësore administrative me palë ppaditëse T.G është vendosur mospranimi i kërkesë padisë nga ana e Gjykates ndërsa çështjet e tjera janë në proces.
- SHSSH ka marr pjesë si person i tretë në proceset gjyqësore civile me objekt : Vlefshmëri masë mbrojtje, Vendosje të fëmijëve në kujdestari të institucioneve të përkujdesit shoqëror etj.

- Janë përgatitur 3 ankimime për Gjykatën Administrative të Apelit si dhe 1 parashtrim për Gjykatën Kushtetuese për çështjen administrative me pale paditëse B.P.
- Janë përgatitur autorizime për përfaqësim të institucionit në Gjykatat Administrative/Civile etj.
- SHSSH ka marr pjesë si person i tretë në proceset gjyqësore civile me objekt : Vlefshmëri masë mbrojtje, Vendosje të fëmijëve në kujdestari të institucioneve të përkujdesit shoqëror etj.

Objektiv II: Organizimi i mbledhjeve të komisionit në zbatim të legjislacionit për përjashtimin doganor për personat që gëzojnë statusin e para-tetraplegjisë

Gjatë vitit 2023, Sektori Juridik pranë Shërbimit Social Shtetëror ka pajisur me vërtetim për përjashtim nga detyrimet doganore të automjeteve në pronësi të 11 personave me status para/tetraplegjie.

Përveç komisioneve për pajisjen me vërtetim zhdoganimi janë sqaruar mbi procedurat qytetarët e paraqitur në institucion.

Objektiv III: Shqyrtimi i kontratave dhe marrëveshjeve të bashkëpunimit ku ka qënë palë SHSSH.

Gjatë vitit 2023 Sektori Juridik pranë Shërbimit Social Shtetëror ka shqyrtuar disa kontrata dhe Marrëveshje Bashkëpunimi si më poshtë vijon:

- Kontrata e ruajtjes fizike te institucionit nga Illyrian Guard.
- Kontrata e shërbimit me objekt: “Hartim projekt-preventiv Zbatimi për Rikonstruksionin e Godinës “Shtëpia e Fëmijëve Shkollor Tiranë”.
- Marrëveshje Bashkëpunimi për zbatimin e planit Kombëtar të Deinstitutionalizimit midis SHSSH, Bashkisë Durrës, Drejtorisë Rajonale Durrës, Nisma “Arsis” dhe Shtëpisë së Fëmijëve Durrës.
- Marrëveshje Bashkëpunimi për zbatimin e planit Kombëtar të Deinstitutionalizimit midis Bashkisë Tiranë, SHSSH, Drejtorisë Rajonale Tiranë, Nisma “Arsis”, Shtëpisë së Fëmijëve Hanna dhe Rozafa dhe Shtëpisë së Fëmijëve Shkollor “Zyber Hallulli”.

Invetarizimi dhe Regjistrimi i Pasurive të Paluajtshme në administrim të SHSSH

Shërbimi Social Shtetëror në zbatim të VKM nr.28, datë 27.01.2023, “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve”, të shkresës nr.1556/1 prot, datë 12.04.2023, protokolluar me tonën nr.5464 prot, datë 23.05.2023 “Për ngritjen e strukturave të posaçme për inventarizimin, plotësimin, përditësimin dhe ndjekjen e procesit deri në regjistrimin e pronave”, ka ngritur strukturën e posaçme me Urdhërin nr.276, datë 26.05.2023, “Për ngritjen e strukturës së posaçme për inventarizimin, plotësimin, përditësimin dhe ndjekjen e procesit deri në regjistrimin e pronave”.

Ka hartuar listën paraprake të pronave në administrim të SHSSH duke evidentuar dhe problematikat përkatëse si dhe e ka dërguar në MSHMS.

Institucionet e varësisë kanë aplikuar në ASHK për rifreskim të kartelave të pasurise dhe lëshim kopje të fragmentit të hartës kadastrale, ku një pjesë e institucioneve ka marr përgjigje dhe është pajisur me informacion të rifkreskuar dhe për një pjesë të aplikimeve nuk është marr përgjigje nga ASHK lidhur statusin juridik të pronësise ose përgjigja nuk është e qartë/kërkohen më shumë të dhëna për pronën. Aktualisht rezultojnë të pajisura me Çertifikatë Pronësie 4 objekte/prona.

Sfidë ngelet regjistrimi i objekteve për të cilat nuk ka pasur regjistrim fillestar të pronës/VKM dhe nuk kemi një përgjigje nga ASHK për statusin juridik të tyre.

Të tjera:

- Sektori Juridik ka qenë pjese e grupeve të punës për hartimin e Rregulloreve të Brendshme për 4 IPSH, në bashkëpunim me sektorët përkatës:
 - Rregullore e Brendshme për Qëndrat e të Moshuarve
 - Rregullore e Brendshme për Shtëpinë e Fëmijëve Shkollor 6-16 vjeç (Zyber Hallulli)
 - Rregullore e Brendshme për Shtëpine e Foshnjës Tiranë.
 - Rregullore e Brendshme për QKTVDHF.
- Sektori Juridik ka marr pjesë në procedurat e prokurimit të blerjeve me vlerë të vogël të realizuara gjatë vitit 2023 si dhe në procedurën e prokurimit me objekt: “Hartim projekt-preventiv Zbatimi për Rikonstruksionin e Godinës “Shtëpia e Fëmijëve Shkollor Tiranë”.
- Sektori juridik ka qenë pjese e Task-Forcës së ngritur për verifikimin social ekonomik në banesë të familjeve përfituese nga skema e ndihmës ekonomike.

III. SEKTORI I PROJEKTEVE

Objektiv I: Ndjekja e ciklit të projekteve dhe organizimi i aktiviteteve

Gjatë vitit 2023 Sektori I Projekteve në bashkëpunim me ASET, Regione Liguria dhe Regione Marche në Itali kanë finalizuar aplikimin për projektin e titulluar “Eldearly – Improving the Elderly Care System in Albania”. Projekti u hartua në kuadër të thirrjes së dytë për projekt-propozime nga IADSA. Projekt-propozimi i Shërbimit Social Shtetëror u mbështet nga IADSA dhe do të nisë zyrtarisht zbatimin në vitin 2024. Zbatimi do të zgjasë 24 muaj. Ky projekt do të sjellë një risi në kujdesin për të moshuarit në Shqipëri pasi përpos ofrimit të shërbimeve publike rezidenciale dhe ditore, do të shtohet ofrimi i një shërbimi në banesë, si edhe ngritja e dy linjave të këshillimit për të moshuarit.

Po ashtu, gjatë vititn 2023 janë organizuar dhe koordinuar një sërë aktiviteteve në kuadër të ditëve të shënuara ose jo. Konkreisht:

- 1 Qershor - Aktivitet argëtues në kuadër të festës së fëmijëve pranë Shtëpisë së Hannah dhe Rozafës;

- Trajnim mbarë-kombëtar për Modelin e Vlerësimit Bio-Psiko-Social me stafet e 37 KVSHAK në të gjithë Shqipërinë;
- 1 Tetor - Dita Ndërkombëtare për të Moshuarit në Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër;
- 19 Tetor - Fushatë ndërgjegjësimi kundër trafikimit në kuadër të muajit kundër trafikimit në persona;
- 24 Nëntor - Aktivitet prezantues me natyrë artistike dhe sportive në Shtëpinë e Fëmijës “Zyber Hallulli”
- 30 Nëntor - Aktivitet ndërgjegjësuës në kuadër të 16 ditëve të aktivizimit kundër dhunës;
- 3 Dhjetor - Aktivitet në kuadër të Ditës Ndërkombëtare për PAK në Qendrën e Zhvillimit Rezidencial Durrës;
- 28 Dhjetor - Aktivitet festiv në Shtëpinë e Foshnjës “Hannah dhe Rozafa” në kuadër të festave të fundvitit.

Objektiv II: Zbatimi i detyrimeve që rrjedhin nga Programi i Transparencës

Gjatë vitit 2023 mbështetur me kërkesat e Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” është bërë transparente veprimtaria e Shërbimit Social Shtetëror përmes përditësimit të faqes zyrtare të web-it dhe komunikimit në rrjetet sociale. Konkretisht:

1. Janë publikuar 12 Buletine Informative dhe 12 Buletine të Donacioneve, të cilat pasqyrohen çdo muaj brenda datës 10 në faqen zyrtare të SHSSH;
2. Është bërë përditësim i Regjistrat të Kërkesave dhe Përgjigjeve çdo 3 muaj;
3. Janë përditësuar rubrikat e raporteve çdo 2 muaj dhe rubrikat e legjislacionit dhe njoftimeve sipas rasteve;
4. Janë mbajtur të përditësuara çdo ditë rrjetet sociale zyrtare me postime rreth veprimtarisë së Drejtorisë së Përgjithshme, Drejtorive Rajonale dhe Institucioneve të Përkujdesit Shoqëror.

Koordinatori për të Drejtën e Informimit në SHSSH ka kthyer 15 përgjigje pa pagesë kërkesave për informacion drejtuar institucionit nga gazetarë investigativë, qytetarë, organizata apo grupe interesi. Në të gjitha rastet janë respektuar standardet ligjore të transparencës dhe afati i kthimit të përgjigjes prej 14 ditësh. Numri i kërkesave përgjatë viteve ka ardhur në ulje, pasi qytetarët kanë pasur më shumë mundësi të informohen edhe përmes rrjeteve sociale zyrtare të SHSSH.

Objektiv IV: Marrëdhëniet me publikun

Gjatë vitit 2023 Sektori i Projekteve ka punuar për trajtimin e të gjitha ankesave dhe kërkesave të qytetarëve për problematika të ndryshme dhe vendosjes së urave të bashkëpunimit me institucionet përkatëse për kthimin e përgjigjes qytetarit brenda afateve ligjore. Konkrektisht:

Portali i Bashkëqeverisjes	Rrjete sociale
638	285

Pjesa më e madhe e rasteve të ardhura në portal kanë qenë në fushën e aftësisë së kufizuar, ku kanë qenë të përqendruara në:

1. Ndryshimin e pagesave të personave të aftësisë së kufizuar me reformën e re ka sjellë një numër të lartë të ankesave pranë KSHA.
2. Mospërfshirja e disa diagnozave në udhëzues që më parë kanë qenë përfitues.
3. Mund të ketë pasur vonesa të përgjigjeve ku në të shumtën e rasteve kanë qenë si pasojë e mosdhënies së të gjitha të dhënave nga qytetarët që e ka zgjatur procesin e verifikimit.

Objektiv V: Monitorimi i medias

Gjatë vitit 2023 janë identifikuar dhe trajtuar 78 raste mediatike, një numër shumë i rritur krahasuar me vitet e mëparshme. Pjesa më e madhe e rasteve janë në fushën e aftësisë së kufizuar dhe potencialisht kjo rritje mund të ketë ardhur nga ndryshimi i skemës së vlerësimit të aftësisë së kufizuar.